

VENDIM
Nr.114, datë 15.2.2017

**PËR HEQJEN NGA FONDI PYJOR PUBLIK DHE PAKËSIMIN NË VOLUM TË
SIPËRFAQES PREJ 6.5 HA NË OBJEKTIN “BRATILA”, TË EKONOMISË PYJORE
“VIDHAN-SKËNDËRBEGAS”, TË RRETHIT GRAMSH, QË DO TË PËRDOREN NGA
SHOQËRIA “VICTORIA INVEST INTERNACIONAL”, SH.P.K. PËR USHTRIMIN E
AKTIVITETIT MINERAR NË SHFRYTËZIMIN E MINERALIT TË HARCBURGITEVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr.9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe të ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave,

VENDOSI:

1. Sipërfaqja pyjore prej 6.5 ha, në ngastrat 66d dhe 68b, në objektin e quajtur “Bratila”, të ekonomisë pyjore “Vidhan-Skëndërbegas”, të rrethit të Gramshit, që do të përdoret nga shoqëria “Victoria Invest Internacional”, sh.p.k. për shfrytëzimin e mineralit të harcburgiteve, të hiqet nga fondi pyjor publik dhe të çregjistrohet nga Kadastra Kombëtare e Pyjeve dhe Kullotave. Lidhja 1, me të dhënat për ngastrat pyjore, dhe harta topografike, me koordinatat e sipërfaqes objekt minerar, i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat përkatëse të pakësimit të sipërfaqes dhe të volumit të lëndës drusore paguhën nga shoqëria “Victoria Invest Internacional”, sh.p.k. në bazë të vendimit nr.391, datë 21.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, të ndryshuar.

3. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shoqëria “Victoria Invest Internacional”, sh.p.k. detyrohet të rehabilitojë sipërfaqen objekt minerar sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore.

4. Bashkia Gramsh dhe shoqëria “Victoria Invest Internacional”, sh.p.k. nënshkruajnë marrëveshje jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi. Një kopje e marrëveshjes, së bashku me projektet e miratuara, dërgohen në Ministrinë e Mjedisit jo më vonë se 10 ditë nga data e nënshkrimit të saj.

5. Sipërfaqet pyjore, sipas pikës 1, të këtij vendimi, mbeten pronë publike e shtetit dhe regjistrohen në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Energjisë dhe Industrisë.

6. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore të identifikuar sipas pikës 1, të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore/kullosore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, objekt shfrytëzimi për aktivitet minerar”.

7. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe shoqëria “Victoria Invest Internacional”, sh.p.k. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**LISTA E NGA STRAVE DHE NËN NGA STRAVE QË DO TË HIQEN NGA
FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PËR USHTRIMIN E AKTIVITETIT
MINERAR NGA SHOQËRIA "VIKTORIA INVEST INTERNACIONAL" sh.p.k.
në qarkun e ELBASANIT**

QARKU ELBASAN

Lidhja 1

ID Prones	Ekon.Pyjore/Kullosore	Ngastra	Perdorimi	Administrimi	Sip. qe hiqen nga fondi pyjor (ha)
EL 66 01 066d	Vidhan-Skenderbegas	66 d	inproduktive	Komuna Skenderbegas	4.7
EL 66 01 068b	Vidhan-Skenderbegas	68 b	inproduktive	Komuna Skenderbegas	1.8
GJITHSEJ					6.50

